

**2** Keqpërdorime në qendrat e azilit  
Dhuna si pasojë e politikave kufizuese

**3** Mekanizmi diskriminues i pretendimit për abuzim  
Diskursi shoqëror i fajtorëve kujdestar

**4** Trajnime dhe informacione të rëndësishme  
Migrant\*et dhe pensioni i pleqërisë në Zvicër

Nr. 4 | Qershor 2021 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Kongresi i Unia 2021: Nisi strategjia organizative dhe procesi reformues

## Një Evropë sociale dhe siguri qëndrimi për të gjithë



Grupi i Interesit të Migracionit të Unia gjatë kongresit të fundit të sindikatës të zhvilluar me 4 e 5 qershor 2021

Rreth 350 delegat të Kongresit në Biel dhe në 14 vendndodhje tjera kanë bërë balancën, kanë vendosur për strategjinë organizative dhe kanë shpall nisjen e një procesi reformues. Zgjedhja e Këshillit Drejtues rishitas me 4 gra dhe aprovimi i rezolutave të rëndësishme mbi temat aktuale rumbullakësuan kongresin.

Hilmi Gashi

Në fjalën hapëse kryetarja e Unia, Vania Alleva theksoi se kongresi i sivjetmë karakterizohet më shumë se kurrë nga kriza globale. Pandemia e Covid-it ka ashpërsuar edhe më shumë pabarazinë sociale dhe pasigurinë. Unia u është gjendur pranë me këshillë dhe vepra konkrete anëtarëve – dhe punëmarrësve tjerë të panumërt – përgjatë krizës së koronës dhe kështu ka kontribuar konsiderueshëm për ta bërë krizën për shumë njerëz më të përballueshme: Në rrafshin politik Unia kontribuon vendosmërisht që edhe shteti të zgjerohet dhe fuqizojë rritjen e tij sociale të solidaritetit.

**Nevojitet një marrëdhënie e qëndrueshme me BE në kuptimin e punëmarrësve**

Sulmi i dyfishtë karshi masave mbrojtëse që mbrojnë pagat – përmes nismës anuluese të SVP/UDC-së si dhe

marrëveshja bilaterale e kuptuar gabimisht – u arrit të zbrapsset. Tani është i nevojshëm dhe i mundshëm ndërrimi i paradigmeve. Zvicra ka nevojë për një marrëdhënie të qëndrueshme me BE, bazuar në interes të popullatës së gjerë. Qendrore janë siguria dhe drejtësia sociale dhe liria e lëvizjes e ndërlidhur fuqishëm me të drejtat e punëmarrësve. Ndër të tjera Zvicra do të duhej të fuqizonte sigurinë e qëndrimit dhe të drejtat sociale e shtetas\*eve të BE-së në Zvicër, gjegjësisht në rast të papunësisë dhe kështu të zbatonte elementet thelbësorë të drejtave qytetare të Unionit.

**Siguri qëndrimi dhe pjesëmarrje për të huajt**

Delegatët i thanë po rezolutës «Varfëria nuk është krim». Kjo rezolutë kërkon siguri për qëndrimi të migrant\*eve. Këta japin një kontrIBUT thelbësor për funksionimin e

patrazuar të Zvicrës dhe shërbimet themelore për sektorët esencial. Megjithatë, ata/o jetojnë në kushte të pasigurta, një parregullsi, të cilën pandemia e ka ashpërsuar edhe më shumë. Andaj, delegatët kërkuar ti epet fund diskriminimit: E drejta për mbështetje shtetërore në situatë emergjence nuk duhet të minohet përmes sanksioneve dhe ligjeve për të huajt. Kjo rezolutë u plotësua me pikën e pjesëmarrjes të të huajve në jetën e Zvicrës: Një shoqëri, e cila çerëkon e popullatës së saj e përjashton nga proceset demokratike nuk paraqet formë korrekte të shoqërisë. Migrant\*et nuk duhet të jenë armatë rezervë e kapitalizmit, prandaj kërkohet të jenë pjesë e jetës politike.

**Jo reformës së paraqitur mbi AHV/AVS**

Kongresi i Unia u shpreh qartas edhe kundër rritjes së moshës së

pensionimit të AHV/AVS për gratë. Parashtrës kursyese është një skandal, pasi gratë qysh tani marrin 1/3 e pensionit më pak se sa burrat dhe iu duhet që ta kalojnë jetën e pleqërisë në kushte tejet të pasigurta. Për to nevojiten pensione më të mira të AHV/AVS e jo moshë më të vjetër pensionimi.

**Historike: Shumicë grash në Këshillin Drejtues**

Këshilli Drejtues i Unia rishitas përbëhet nga katër gra dhe tre burra. Bruna Campanello dhe Yves Defferrard janë zgjedhur anëtarë të ri të Këshillit Drejtues. Kryetarja Vania Alleva është vërtuar me një rezultat të shkëlqyer në funksionin e saj. Janë rizgjedhur në Këshillin Drejtues edhe anëtarët e deritashëm Véronique Polito, Martin Tanner, Nico Lutz dhe Renate Schoch.

### Editorial



#### «Koha e fundit»

Kongresi i Unia nën moton «koha e fundit» më shumë se kurdoherë më parë u karakterizua me krizën globale: papunësia, kushtet e pasigurta të punës, emergjencia klimatike dhe kriza shëndetësore. Dhe ajo me forcë brutale ka bërë të qartë se sa të lëndueshëm – por edhe sa të rëndësishëm e të pazëvendësueshëm – janë institucionet dhe organizatat e solidaritetit.

Solidariteti i jetuar është thelbi përcaktues i Unia. Duke iu gjetur anëtarëve të saj – por edhe shumë punëmarrësve tjerë – gjatë krizës së koronës me këshillë e vepra konkrete, ka bërë që kriza të jetë më e durueshme. Në rrafshin politik kontributi i Unia ka qenë vendimtar që edhe shteti të zgjerohet dhe forcojë rrejtët e tija sociale.

Ne përballemi me një erë të vrazhdë, mirëpo ne mund të mbrohemi suksesshëm; kundër sulmeve mbi pensionimin në moshën 60 vjeç në ndërtimtarë, tek MEM-industria, tek KKP në gastronomi. Ne kemi mund të zbrapsim suksesshëm përkeqësimet në ligjin e punës, sulmet drejtuar mbrojtje së pagave dhe nismën ksenofobe të anulimit të SVP/UDC-së.

Unia është e rëndësishme dhe ajo duhet të mbetet e pamposhtur. Përmes debatit reformues 2.0 ne duam të jemi gjendje, që ne të gjejmë përgjigje bindëse sa i përket digjitalizimit, pasigurisë, tertiarizimit dhe globalizimit të botës së punës.

Unë jam mirënjohëse të jem kryetare e një Organizate, e cila ka synim përmirësimin e kushteve të punës dhe jetesës të punëmarrësve, e që donë të kontribuojë për drejtësinë sociale dhe për mbështetjen e përbashkët shoqërore. Rroftë Unia!

Vania Alleva

## News

## Nisma popullore AHV/AVS x13

Më 28 maj 2021 janë dorëzuar të 137 550 nënshkrimet për nismën «për një jetë më të mirë në pleqëri». Nisma ka për qëllim të arrijë një pension të 13-të të AHV/AVS. Rritja e pensionit të AHV/AVS është urgjentisht e domosdoshme. Pas heqjes së premive të sigurimit shëndetësor dhe qerasë nuk mbetet më pension i mjaftueshëm për të jetuar. Pikërisht për gratë AHV/AVS është shtylla më e rëndësishme e sigurimit në pleqëri, pasi shumica nga to nuk kanë fare arkë pensioni (trusti). Edhe ata/o që marrin të ardhura shtesë (EL/PC) duhet të marrin një pension të 13-të mujor. AHV/AVS ka raportin më të mirë çmim-performancë dhe për shumicën dërrmuese të popullsisë paraqet përmirësimin më të favorshëm të pensioneve.

## Rregullimi i kohës së pushimit për shoferët do të përmirësohet

Parlamenti dëshiron që shofer\*et e kamionëve të mos kalojnë kohën e pushimit në automjetet. Shofer\*et nuk janë të vetmit në degën e logjistikës, të cilët i nënshtrohen presionit të madh dhe që nuk mund ti përmbahen kohës së pushimit. Andaj është me rëndësi që të vlejë obligimi për regjistrimin e kohës së vozitjes edhe për automjetet më të vogla me peshë të përgjithshme deri në 2.5 ton, kështu që të mund të kontrollohet respektimi i kohës së pushimeve dhe pauzave. Rregullorja synon të frenojë dumping-un social. Sidoqoftë, për shofer\*et është e nevojshme mbrojtja e mëtejshme.

## Të ndalen shkarkimet masive nga puna tek nënkontraktuesi Smood!

Situata e shpërndarës\*eve në Gjenevë dhe Waadt, të cilët punojnë për platformën e shpërndarjes Smood, është edhe më tej e vështirë. Drejtoria e AlloService dhe Smood kanë bërë shumë pak propozime konkrete. Nëse nuk do të ketë marrëveshje në javët e ardhshme disa dhjetëra njerëz do të mbeten pa punë. Unia kritikon edhe partneritetin strategjik të Migros-it me Smood. Migros-i që nga viti 2019 është aksionar dhe myshteri e Smood. Migros-i duhet që të merre përsipër përgjegjësinë për kushtet e pasigurta të punës në fund të zinxhirit të furnizimit të produktit ose ushqimit (Last Mile Delivery).

## Te hiqen listat e zezat, t'i epet fund premive për kokë!

Në sesionin e verës do të merren vendime udhërrëfyese vendimtare për financimin dhe për qasjen në lami të shëndetësive. Sipas kushtetutës federale secili person në Zvicër duhet të marrë «përkujdesjen e nevojshme për shëndetin personal». Që nga koha e futjes së ashtuquajturave «lista të zezat» në vitin 2010 ky parim shkelet seriozisht. Qysh tani çdo i 5 person i siguruar për arsye financiare heq dorë nga përfitimet e nevojshme shëndetësore. Asgjë pas pandemisë nuk mund të arsyetojë që arkat e sigurimeve shëndetësore janë ulur në një grumbull prej më shumë se 12 miliardë franga rezervash, të cilat sa vijnë e rriten pandërprerë. Këto para u takojnë të siguruarve dhe gjysma e tyre duhet tu kthehen atyre.

## KKP për Ndërtimtari 2022

2022 skadon Kontrata Kombëtare e Punës për ndërtimtarinë kryesore (LMV/CN). Ajo duhet të re negociohet mes punëtorëve të ndërtimtarisë/sindikatave dhe Shoqatës të sipërmarrësve zviceranë. Industrisë së ndërtimit edhe përkundër pandemisë i kanë shkuar punët mirë. Punëtorët e ndërtimtarisë kanë kontribuar më së shumti për këtë mbarësi. Orët e tepërta të punës dhe koha e gjatë e udhëtimit për në punishte janë bërë përditshme, ndërsa aksidentet e rënda sa vijnë e rriten. Punëtorët e ndërtimtarisë meritojnë më shumë mbrojtje. Në KKP 2022 nevojiten kushte më të mira pune!

## Aksionet në filialet dhe ndërmarrjet e Migros-it

## Personeli meriton paga më të larta dhe një KKP për të gjithë

Që nga fillimi i pandemisë personeli i Migros-it punon fort, për të siguruar furnizimin elementar për popullatën. Migros-i ka korrur frytet e punës: në vitin 2020 fitimi i është shtuar dukshëm! Mirëpo pagat rriten më pak se kudo tjetër, puna sa vjen e bëhet më e stresuar dhe gjithnjë e më pak njerëz janë të mbrojtur nga KKP e Migros-it.

Darinka Filipovic

Falë angazhimit të palodhshëm të punonjësve në filialet e Migros-it, në logjistikë dhe në prodhimtari, Migros-i në vitin 2020 ka shënuar një rezultat të mirë. Falë personelit është siguruar furnizimi i popullatës. Kësaj duhet shtuar faktin se personeli i Migros-it ketë vepër arti e kanë kryer me më pak koleg\*ë pune. Në vitin e kaluar në kooperativë janë hequr 1500 vende pune.

## Puna e personelit nuk shpërblehet sa duhet

Rritja e pagave në sektorin e artikujve ushqimor ka vite që është më e ulëta. Lartësia e premisë së koronës nuk është në përputhje as me angazhimin e madh të personelit e as me fitimin e Migros-it. Gjithnjë e më shumë punonjës janë duke u përjashtuar nga mbrojtja e KKP të Migros-it dhe kanë kontrata pune të pasigurta.

## Kërkesa të thjeshta dhe të qarta

Për Unia motoja e Migros-it «thjeshtë të jetosh mirë» duhet të vlejë edhe për punonjësit. Unia kërkon, paga me të larta për të gjithë, një KKP të mirë, e cila mbron të gjithë punonjësit dhe një kompensim të 100% për punën me ko-

hë të shkurtuar. Migros-i duhet të ndal përkeqësimin e kushteve të punës përmes delegimit të drejtave të veçanta dhe kontraktimit të jashtëm të shërbimeve. Gjithashtu edhe shkarkimin e personelit nga puna.

## Aksionet në filialet dhe ndërmarrjet e Migros-it

Në «Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Punëtorëve» Unia ishte prezentë në

50 filiale në të gjithë Zvicrën. Ajo u ka shpërndarë shitës\*eve krem duarsh me sloganin «Ne duam më shumë se sa përmirësime kozmetike» dhe ka ftuar myshterinj\*et që në online të solidarizohen me kërkesat e cekura.

Përfundimisht në Migros nevojiten paga më të larta dhe një KKP për të gjithë!



Motoja e Migros-it: «Vetëm të jetojmë mirë» duhet të vlejë edhe për punonjësit!

## Keqpërdorimet në qendrat e azilit

## Dhuna në qendrat e azilit si pasojë e politikës kufizuese

Sipas raportit të komisionit nacional për parandalimin e torturës (NKVF) në qendrat federale të azilit (BAZ) vije përsëritshëm deri tek shpërthimi i dhunës e cila drejtohet sikur kundër punonjësve ashtu edhe kundër personave azilkërkues. Personeli i sigurues ka intervenuar shumë herë në Qendrat e vizituara federale të azilit me përqendrim të fiksuar trupor, xhel djegës si dhe zbatim të «dhomës reflektuese». Janë hapur disa procedura penale ndaj bashkëpunëtorëve të personelit sigurues.

Marek Wieruszewski

Privatizimin e vendosjes dhe kujdesit të azilkërkuesve kanë zbuluar ndërmarrjet e orientuara nga profiti. Ato ofrojnë shërbime për federatën dhe kantonet dhe nga kjo bëjnë biznes fitimprurës. Kjo bëhet në kurriz të kujdesit adekuat për azilkërkuesit nga personeli i shkolluar profesional, Ndërmarrjeve të sigurimit privat NKVF ju sugjeron që për punonjësit e tyre të parashihet një shkollim i gjatë dhe bazik. Sipas vlerësimit të komisionit ekziston një potencial përmirësues serioz tek rastet e sjelljes në situatë konfliktit, tek parandalimi dhe dhunës dhe tek pretendimet për dhunë.

## Kritika nga ana e organizatave për të drejtat e njeriut

Kritika e komisionit merr përforcim shtese edhe nga raportet e organizatave të shumta nga rrafshi i azilit dhe migracionit. Kështu fjala bie Solidarité Tattes dhe Droit de Rester raportuan mbi keqtrajtimet masive nga ana e personelit të sigurimit në qendrën federale të azilit në Giffers tek Fribourg-u. Është fakt: privatizimi i kujdesit dhe mbikëqyrjes në qendrat federale të azilit qon në kursime financiare në kurriz të punëmarrësve dhe të kushteve jetësore si dhe shëndetit të azilkërkuesve.

## Hulumtimet nga gazeta «WOZ» dhe emisionit televiziv «Rundschau»

Një hulumtim i përbashkët nga «gazeta javore WOZ» dhe emisioni «Rundschau» zbulon raste tjera të dhunës në qendrat e azilit. Një rast në Altstätten me një azilkërkues 16 vjeçar përfundon me një qëndrim spitalor 3 ditor. Gjithsej në vitin 2020 në tërë Zvicrën janë lajmëruar 1539 raste, edhe pse numri i kërkesave për azil në të njëjtën periudhë kohore është zvogëluar për rreth një çerek.



Kërkohe që të ndalet dhuna në qendrat federale të azilkërkuesve

## SEM duhet të veproj

Situata e personave azilkërkues është veçanërisht e pasigurt. Pavarësisht nga arsyeja e arratisë ata nga vet udhëtimi i rrezikshëm e i tendosur i arratisjes janë fort të traumatizuar. Ata shpesh vendosen në vende me rrezikshmëri ku masat e kufizimit të lirisë janë edhe më tej ngarkuese. SEM si përgjegjësi i përgjithshëm kryesor duhet të sigurojë, që ndërmarrjet e sigurimit të ngarkuara nga ta, të rekrutojnë personel sigurimi profesional e me përvojë dhe këta ti trajtojë në mënyrë specifike e themelore për angazhim në qendrat federale të azilit. Nevojitet gjithashtu kushte të mira pune dhe paga korrekte për personelin. Politika kufizuese e azilit nuk duhet të lejojë, që azilkërkuesit dhe personeli të nxiten kundër njëri tjetrit dhe që të jenë të detyruar të jetojnë e punojnë në një situatë të ngarkuar konfliktit.

Mekanizmi diskriminues i pretendimit për abuzim

## Më e rëndësishmja është, që dikush të jetë fajtor

Dyshimet, akuzat për keqpërdorim dhe fajtorët kujdestar u lejojnë politikanëve të djathtë, me aprovimin e shumicës së popullatës, zbatojnë kufizime, të cilat shkelin të drejtat themelore të njeriut. Ne mund të reagojmë dhe të veprojmë!

Marie Saulnier Bloch und Julius Kopp

Nëse unë nuk mund të gjej banesë të pagueshme, vendi betonohet, nuk kam punë dhe duhet të pres në kolona të gjata automjetesh, atëherë të huajt janë fajtor. Jo lakmia e pronarëve të patundshmërive, jo të pasurit me banesat e dyta, vilat me hapësira të mëdha. Edhe kur pengesat për ndihmë sociale janë të mëdha, janë ata fajtorë, të cilët gjoja bëjnë keqpërdorime. Dhe këtu ne jemi tek diskursi i njohur i të së djathtës. Diskursi i abuzimit grupet e tëra i venë nën dyshim të përgjithshëm dhe nga ta krijon fajtorë kujdestar.

Pa marrë parasysh a të huaj\*<sup>a</sup>, jud\*<sup>e</sup>, mysliman\*<sup>e</sup>, kosovar\*<sup>e</sup>, i/e varfër, i/e sëmurë, prindi i/e vetëm apo i/e moshuar – një fajtor kujdestar gjendet shpejtë. Pastaj ne dëgjojmë për «refugjat ekonomik», «parazit social», sa të këmbësorë janë paragjykimet, po aq i thjeshtë është funksioni i tyre. Ato shërbejnë për të maskuar dhe për t'u shpërqendruar nga politika e shpërndarjes së pushtetit dhe pasurisë në shoqërinë tonë, që në të vërtetë janë të djathtët dhe liberalët ekonomik, të cilët përpiqen që të shkatërrojnë çdo përpjekje për drejtësi sociale. Janë ithtarët e SVP/UDC, FDP/PLR me kompani, të cilët nxisin pandërprerë diskursin e fajtorëve kujdestar, që në sfond edhe më tej të luftojnë kundër interesave të punëmarrësve dhe vazhdojnë të kënaqin lakminë e tyre për fitim.



E djathta si nxitëse e politikave fajësuese, kufizuese e përjashtuese

### Çka bënë diskursi i fajtorëve kujdestarë me një shoqëri?

Nëse është krijuar fajtori kujdestar edhe në opinionin publik, të djathtët dhe liberalët e ekonomisë ofrojnë masa, për të ndaluar në mënyrë preventive abuzimin e pretenduar nga ky grup njerëzish. Të drejtat dhe liritë e kësaj grupe pastaj vijnë duke u kufizuar, të prekurit bëhen qytetarë të klasit të dytë. Shumica e popullsisë e pranon këtë pretendim, që kështu të shmangët kërcënimi për sistemin shoqëror dhe ekonomik. Bëhet normale, që disa të kenë më shumë të drejta se sa të tjerët. Kultura e mosbesimit e mundëson pra, të legjitimohet poshtërimi i disa njerëzve dhe krijon në mori ligjesh e praktikash, të cilat në fund të fundit kufizojnë të drejtat e të gjithëve.

### Ne nuk do të lejojmë!

Fajtorët kujdestarë nuk janë zgjedhur rastësisht, dhe kjo është një shembull i mirë për atë se çka nënkupton kritika e kryqëzimit. Nëse ju për shembull jeni një i huaj dhe një grua, diskriminimi është grumbullues, i përzier dhe i fuqizuar. Disa shembuj: më herët gratë e martuara kanë qenë të përjashtuara nga marrja e parave të papunësisë. Sot gratë paguhet më keq, por paguajnë deri 80% më shumë për sigurimin e tyre shtesë se sa burrat. Një nga 6 gra mbi moshën 65 vjeç jeton në varfëri dhe në të njëjtën kohë të gjitha gratë e huaja rrezikojnë të humbin lejet e tyre të qëndrimit nëse duan të përfitojnë nga e drejta e ndihmës sociale. Gjithmonë me pretextin e keqpërdorimit dhe mungesa e të ardhurave.

Përjashtimi i një pjese të popullatës me arsyetimin e gjoja luftimit të abuzimit u shërbejnë vetëm atyre, të cilët duan të ruajnë dhe të rrisin përfitimet e tyre përmes përkeqësimit e kushteve të jetesës së punëmarrësve. Nëse ne duam të ndalojmë këtë politik diskriminuese, ne duhet të drejtojmë gishtin tregues kundër të gjithë atyre, që krijojnë fajtorë kujdestar. Dhe ne duhet të jemi të vetëdijshëm, se ne si punëmarrës duhet të qëndrojmë bashkë dhe të ndërlihim betejat tona.

## 20 vite lëvizje e SansPapiers

### Çka ke mbetur nga lëvizja fillestare

Kanë kaluar dy dekada nga «Coming out» (dalja në dukje) të lëvizjes SansPapiers. Pushtim kishash, demonstrata, aksione të panumërta dhe parashtrësia parlamentare dëshmuar për një frymë optimizmi. Ndërlidhur me këtë ishte edhe shpresa për një hapje, për një politikë të re njerëzore të azilit dhe migracionit, përtej punës individuale rraskapitëse.

Pierre-Alain Niklaus

A ia ka vlejtur ky angazhim? Mua më kujtohen festimet e përbashkëta kur arrinim të merrnim një leje. Atëherë mendoj se ia ka vlejtur përpjekja jonë. Sa herë më shkon mendja tek vizitat e shpeshata që u bëja SansPapiers-ëve që ishin në paraburgim për dëbim, veçanërisht në 2002 dhe 2003, zhytem në mendime. Kur mendoj se sa angazhim e punë rastesh individuale duhet të bënim, shpesh në formë përzierje të parashtrimeve ligjore, punës politike dhe protestave publike, në mënyrë që të kalonim «rastet» e qarta, atëherë fillon një gërmim i vërtetë mendimesh. Si është e mundur që pas 20 vitesh lufte dhënia e lejeve në kantonet e shumta edhe më tej ec me kaq vështirësi?

Një problem në veti paraqet varësia nga ligjet federale. Shumë e shumë parashtrësia kantonale për një përmirësim të situatës së SansPapiers-ve mbeten pa ndikim, pasi entet e migracionit vepimet e tyre të ndërmarra i legjitimojnë drejtpërsëdrejti nga Berna zyrtare. Presioni nga rruga në vitin 2001 ishte i madh, shprehja e simpatisë nga ana e popullatës morri krah edhe në vitet vijuese. Mirëpo kjo nuk ishte e mjaftueshme, për të ndryshuar sadopak mentalitetin e mbrojtjes nga migracioni tek autoritetet përgjegjëse.

Shprehur ndryshe: Sa më pak të drejta të ketë për SansPapiers, aq më të ngatërruara bëhen mundësitë për legalizim, aq më shumë mbretëron arbitrariteti – edhe në formë të dallimeve të papritura kantonale. Dhe praktikat varen po aq më shumë nga personalitetet e veçanta të ekzekutivit. Këtu më duhet të formulojë edhe pakënaqësitë e mija në raport me partitë e majta: Departamentet juridike dhe të policisë gjithnjë më shpesh u lihen të djathtëve për ti drejtuar. Ato nuk vlejnin si departamente kyçe. Por: në këto departamente përcaktohen bazat dhe zbatohen

ligjet, të cilat prekin thellë jetën e të gjithë njerëzve, jo vetëm të SansPapiers-ve. Njerëzit me leje F, B, bile edhe me C në ndërkohë duhet të llogarisin që do të shihen si njerëz të klasit të dytë, kur fjala bie humbin vendin e tyre të punës. Të gjitha aspektet qendrore për partitë e majta, të cilat në flamujt e tyre kanë shënuar të drejtat e njeriut dhe migrant\*et i gjykojnë si potencial të elektoratit zgjedhor.

Dëshira im për 20 vjetorin jubilar: Ambientet e së majtës dhe ndryshim vullneti për departamentet e policisë dhe drejtësisë!



## Intervista



## 14 qershori dhe migrantet

### Të forcohen të drejtat dhe perspektivat e migrantëve

14 qershori është një datë e rëndësishme për gratë në Zvicër. Gra të profesioneve të ndryshme, moshe e nacionaliteti duan të drejta të barabarta për gratë. Migrantet diskriminohen dyfish, në njërin anë si gra dhe në anën tjetër si migrante. Ato kanë më shumë arsye për të bërë greve dhe për të protestuar në rrugë.

Tahmina nga Azerbajxhani thotë: Gratë i nënshtrohen formave të ndryshme të diskriminimit shkakut i prejardhjes, ngjyrës së lëkurës, religjionit apo kulturës. "Për mua kjo grevë e grave/greva feministe një rast më shumë për të luftuar këto fenomene dhe për të ndikuar më shumë. Unë dua të shfrytëzoj këtë rast për të bërë ti ditur publikisht shqetësimet, nevojat, preokupimet dhe kërkesat e migrantëve dhe grave refugjate. Zëri ynë duhet të dëgjohej për tu bërë në një shoqëri solidare e pa diskriminim, e në të cilën ne krijojmë për të gjithë të drejta dhe shanse të barabarta. Unë dua në këtë grevë të dëgjohej e kuptohet si një zë që flet për migrantet e refugjatet dhe që bashkë me feministet tjera ndryshon dhe përmirëson këtë shoqëri.

Zahra nga Siria po merr pjesë gjithashtu. Për te janë këshillat dhe informacionet për migrantet që duan të arsimohen më tej, në të gjitha gjuhët e migrantëve të rëndësishme. Përkujdesje falas për fëmijë, programe nxitëse dhe shkolllime interne për migrantet, rrjete sigurie sociale dhe më shumë gra me sfond migracioni në parlament, janë kërkesat e saj.

Olga nga Polonia lufton për të drejta të grave. Fjalën luftë ajo e kupton «si diçka që duhet të mënjanohej, por jo personi, por armiqtë e shoqërisë sonë, si: dhuna, racizmi, varfëria, diskriminimi, kufizimi, varësia... Mjerisht diskriminim të madh ne vërejmë edhe më tej në tregun e punës», thotë ajo. Konkretisht me rastin e punësimit, paga, shanset e ngritjes në karrierë, apo mbrojtje në punë nga ngacmimet raciste e seksiste. Grupet më të prekura nga këto parregullsi janë gratë, para së gjithash migrantet. Ne migrantet nuk vijmë këtu vetëm për të marrë, por edhe për të dhënë. Ne duam me angazhimin dhe përvojat tona që të mbështesim shoqërinë zvicerane, mirëpo pos kësaj edhe të fuqizojmë pozitën tonë, të drejtat dhe perspektivat tona. Mjerisht diplomat dhe arsimimi ynë nga vendet tjera rrallë se pranohen, gjë që kufizon tregun e punës dhe resurset tona nuk vlerësohen drejtë. Andaj ne migrantet kemi nevojë për mbështetje të mirë -programe dhe mbështetje financiare për të pas mundësi të kyçemi drejtë në këtë botë. Përmirësimet në këtë fushë për të gjithë ne – për gra, burra, fëmijë dhe para së gjithash për Zvicrën do të binte një potencial pozitiv.

Emine Sariaslan

## Ju pyesni, Unia përgjigjet

### Vend i ri i punës: A ndihmon Arka e Papunësisë për trajnim?

Unë jam i gjeneratës 1959 dhe kam mbaruar për mekanik. Ka më shumë s enjë vit që jam duke kërkuar punësim. Tani pas një kohe të gjatë jam ftuar për një bisedë prezantuese. Firma më ka sinjalizuar se është e interesuar për bashkëpunim, por se ka drojë se unë nuk jam më në rrjedhat e reja të tekniks. A ka nga ana e sigurimit së papunësisë ndonjë mbështetje të veçantë për mua?

**Nicole Debrunner:** Po. Sigurimi mund të paguajë shtesën trajnuese në një ndërmarrje për personat e siguruar. Kjo do të duhej të motivonte firmat që të punësojnë personat, të cilët kanë nevojë për trajnim. Punonjësit fillimisht nuk mund të japin kontributin e plotë në punë, andaj edhe firmat nuk i punësojnë më tej. Kjo shtesë u dedikohet rasteve të veçanta që duhet të mundësojnë përfshirjen afatgjatë dhe njëkohësisht të mënjanojnë edhe dumpingun në paga. Shtojca trajnuese mbulojnë diferencën mes pagës që paguan ndërmarrja dhe «pagës normale» (më së shumti 12350 franga), e e cila pritet pas trajnimit. Pasi që jeni mbi moshën 50 vjeç, në parim keni të drejtën e shtojcës trajnuese 12 mujore, e cila është në lartësinë 60% të pagës mujore normale, mirëpo e cila pas 6 muajsh reduktohet në 40%. Sikur të ishit më i ri se 50 vjeç përshkallëzimi do të bëhej pas 2 muajsh. Për tu lejuar shtojca trajnuese, ju duhet të shtroni kërkesën përmes RAV/OVP (Entit të regjionit tuaj për ndërmjetësim pune).

(Work, 7.5.2021)

### Arka pensionale: përkundër shkarkimit edhe më tej i siguruar?

Unë jam 62 vjeç. Tani më kanë larguar nga puna. Natyrisht që jam i merakosur për pensionin tim të pleqërisë. Plani im ka kohë që ka qenë të marr një pension nga arka pensionale, pasi unë shkak i mosnjohjes së çështjeve financiare nuk kam besim se ku mund ta përdori kapitalin tim ë pleqërisë në mënyrë përfituese. Deri më tani kam menduar gjithmonë se pas përfundimit të marrëdhënies së punës kapitalin tim të kursyer ta nxjerri dhe ta vendosi në një konto llogarie përfitimesh, deri sa të gjej një vend të ri pune dhe të sigurohem në një arkë të re pensionale. Një koleg tani më ka thënë se unë mund të mbetem i siguruar edhe më tej tek akra ime e vjetër pensionale dhe më vonë të marr edhe një pension nga kjo. A qëndron kjo?

**Regula Dick:** Po. Personat, të cilët kanë arritur moshën 58 vjeç e të cilëve punëdhënësi u ka dhënë dorëheqje nga puna, kanë të drejtën, që të sigurohen edhe me tej tek arka e tyre pensionale. Kjo vlen nga 1 janari 2021. Është mundur që të sigurohen vetëm edhe kundër rreziqeve të invaliditetit dhe vdekjes, apo edhe më tej të kursejnë për pleqëri. Pasi që nuk jeni më në marrëdhënie pune. Duhet që kontributet për arkën pensionale tani ti paguani vetëm ju. Në arritjen e moshës së pensionit ju sipas planifikimit merrni një pension nga arka pensionale. Mirë ta dini: këtë sigurim mund ta anuloni në çdo kohë. Nëse sigurimi zgjat më shumë se dy vite, si pasojë janë disa kufizime: përfitimet nga sigurimi më vonë duhet të tërhiqen si pension – përjashto nëse rregullorja e sigurimit të arkës pensionale parasheh tërheqjen në formë kapitali. Dhe përfitimet e daljes nuk mund të përdoren për blerje banese për nevoja personale apo të shërbejnë si garant. Gjithsesi duhet të kërkonit të informoheni sa më parë nga arka e juaj pensionale mbi kushtet e sigurimit të mëtejme.

(Work, 21.5.2021)

### Pushimi i atësisë: Cilat janë ndikimet në afatet e largimit nga puna?

Gruaja ime para pak kohësh jemi bërë prindër. Shkurt para kësaj më anë përjashtuar nga puna. Unë dua të marrë sa më parë që është mundur pushimin tim të atësisë. Shefi im është i pajtimit. Mirëpo, problemi im është se afati i largimit nga puna më nevojitet për kërkim të vendit të ri të punës. Çka ndodh me afatin e shkarkimit tim, nëse unë bëj pushim atësie: a do të shkurohet afati? Dhe a duhet që të aplikoj për punë edhe gjatë pushimit të atësisë?

**Myriam Muff:** Jo, as njëra as tjetra. Afati i shkarkimit nuk shkurohet, por zgjatet për kohën ende të pashfrytëzuar të pushimit të atësisë – në rastin tuaj për gjithë kohëzgjatjen e pushimit të atësisë prej dy javësh. Kjo është e rregulluar në Nenin 335c, Paragrafi 3 i të drejtës obliguese. Gjatë pushimit të atësisë ju nuk duhet as të aplikoni për punë. Këtë nuk duhet ta bëni edhe nëse jeni i papunë dhe juve Enti regjional për ndërmjetësim pune ju ka lejuar pushimin e atësisë. Kjo është rregulluar me urdhëresën e Seco 2021/4 Pushimi atësisë dhe kompensimi gjatë kërkimit të vendit të punës. Pra ju pushimin tuaj të atësisë mund ta shfrytëzoni plotësisht për t'iu përkushtuar fëmijës tuaj dhe të mbështetjes së gruas tuaj. Tek pastaj mund të kërkonit punë dhe sipas nevojës të lajmëroheni tek arka e papunësisë. Me rëndësi: Marrëdhënia e juaj e punës nuk përfundon sikur zakonisht në fund të muajit. Kjo shkak i zgjatjes së afatit të shkarkimit i kushtëzuar nga pushimi i atësisë.

(Work, 23.4.2021)

## Ti punon në gastronomi apo në pastrim dhe dëshiron arsimim të mëtejme profesional?

Progredir – një arsimim profesional për migrantet në gastronomi dhe në pastrim:

- Ka vite që TI je duke punuar në gastronomi apo në pastrim?
- A dëshiron TI të pasurosh njohuritë gjuhësore dhe të thellosh aftësitë tua profesionale?
- A dëshiron TI të fitosh diplomë profesionale në gastronomi apo në pastrim?

### Ke interesim? Merr kontakt me ne!

Arsimimi fillon në gusht 2021 dhe zhvillohet në Vevey.

### Këtu mund të lajmërohesh për takimin informues dhe të marrësh informacione tjera:

ECAP Vaud, Andrea Leoni, T+41 320 13 27, aleoni@ecap.ch

[www.progredir.ch](http://www.progredir.ch)



Das Bildungsinstitut der Gewerkschaften

## Pensionimi i pleqërisë në Zvicër – për anëtarët shqipfolës

Si funksionon sistemi i pensionimit në Zvicër? Si bëhet llogaritja e viteve kontributive në Zvicër dhe në vendin e prejardhjes? Cilët hapa duhet të ndërmerren paraprakisht dhe cilat janë pasojat në rast të kthimit në vendin e prejardhjes? Pjesëmarrësit do të informohen edhe për vendkëshillimet dhe institutet e autorizuara, ku të interesuarit mund të drejtohen sipas nevojës.

<b>Përmbajtja</b>	Skruktura dhe funksionimi i pensionimit të pleqërisë në Zvicër, marrëveshjet ndërshtetërore me vendet e prejardhjes, pasqyrë e vendkëshillimeve dhe institucioneve të autorizuara
<b>Referenti</b>	Ruzhdi Ibrahim (Unia)
<b>Data</b>	30.10.2021 – 31.10.2021
<b>Kohëzgjatja e kursit</b>	2 Ditë (me fjetje)
<b>Vendi</b>	Vitznau, Hotel Flora Alpina
<b>Tarifa e kursit</b>	Anëtarët falas   Jo-anëtarët Fr. 820.00
<b>Ushqimi</b>	Anëtarët: falas   Jo-anëtarët Fr. 160.00
<b>Fjetja</b>	Anëtarët falas   Jo-anëtarët Fr. 190.00

### Përmbajtja (Regjistrimi i fundit është 4 javë para se të filloj kursit)

Pensionimi i pleqërisë në Zvicër - për anëtarët shqipfolës | Data: 30.10.2021 | Numri i kursit: D1.8.2115

Femër  Mashkull

Gjuha e korrespondencës:  Gjermanisht  Frëngjisht

Mbiemri \_\_\_\_\_ Emri \_\_\_\_\_

Profesioni \_\_\_\_\_ Rruga \_\_\_\_\_

Kodi Postar \_\_\_\_\_ Vendi \_\_\_\_\_

Telefoni privat \_\_\_\_\_ Numri i telefonit të firmës \_\_\_\_\_

Telefoni mobil \_\_\_\_\_ E-Mail \_\_\_\_\_

Data e lindjes \_\_\_\_\_ Punëdhënësi \_\_\_\_\_

Unë jam një anëtar i sindikatës \_\_\_\_\_ Numri i Anëtarit \_\_\_\_\_

Unë kam një funksion në Sindikatë  Po, si Anëtar i besueshëm  Përfaqësues i personelit  Kryesi \_\_\_\_\_

Data dhe nënshkrimi \_\_\_\_\_

MOVENDO, Monbijoustrasse 61, 3007 Bern · Telefon 031 370 00 70, · [info@movendo.ch](mailto:info@movendo.ch), [www.movendo.ch](http://www.movendo.ch)